



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 97

Prishtinë, më 11.12.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina dhe Boban Todorović.

Munguan : Daut Haradinaj, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 3.12.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shfrytëzimin dhe administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e komplekseve memoriale,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua duke hequr pikën rreth ndërtesave në bashkëpronësi pasi që është kërkuar nga zyrtarët e projektit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.12.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3.12.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e komplekseve memoriale

Kryetari i Komisionit falënderoi për angazhimin e MMPH me rastin e dërgimit të plotësimeve të kërkuara nga Komisioni dhe vazhdoi procedimin e Projektligjit si vijon :

Neni 1 – mbetet si është në Projektligj.

Amendamenti 1

Neni 2, pas nënparagrafit 1.2. shtohet nënparagrafi i radhës :

1.3. Zonat e veçanta i shpallë Qeveria me vendim të veçantë ndërsa menaxhimi bartet tek AMKMK- si organ në kuadër të Kuvendit.

Pas nënparagrafit 1.10, shtohet nënparagrafi i radhës:

1.11 Revista - Agjencia do të botoi një revistë vjetore për aktivitetet e AMKMK-së.

Amendamenti 2

Neni 3, paragrafi 5, pas fjalës “WEB-faqes” shtohet “**dhe revistës**”.

Në paragrafin 6, fjala e fundit “Qeveri” zëvendësohet me “**Kuvendin**”. (Të konsultohet departamenti Ligjor i Kuvendit).

Amendamenti 3

Neni 4, në paragrafin 1 fjala “qeveritar” zëvendësohet me “i Kuvendit”.

Në paragrafin 2 në fund shtohet : “**dhe i raporton me shkrim një herë në vit Kuvendit të Kosovës**”.

Amendamenti 4

Neni 7, riformulohet paragrafi 2 :

Agjencia menaxhon buxhetin në mënyrë të pavarur sipas Ligjit Nr. 03-L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjit Nr.03-L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03-L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. (Të konsultohet Departamenti Ligjor a duhet shënuar numrat e Ligjeve).

Amendamenti 5

Neni 8, fjala “Qeveria” në fund zëvendësohet me “**Kryeshefi Ekzekutiv**”.

Amendamenti 6

Te **Neni 10** të sqarohet mënyra e zgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv. (Të konsultohet Departamenti Ligjor).

Amendamenti 7

Neni 11, riformulohet :

Neni 11
Nxjerrja e Akteve Nënligjore

1. Për zbatimin e këtij Ligji Agjencia përkatësisht Kryeshefi Ekzekutiv do të miratoj Aktet nënligjore në afat prej 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.
2. Akte nënligjore të cilat do të nxirren janë :
 1. Stema identifikuese e AMKMK-së,
 2. Struktura Organizative e AMKMK-së,
 3. Procedura e Gradimit të punonjësve të AMKMK-së,
 4. Përcaktimi i shtesave në paga dhe benificioneve tjera për punonjësit e AMKMK-së dhe
 5. Përcaktimi i Kriteve të Komplekseve dhe Memorialëve.

Amendamenti 8

Pjesë përbërëse e këtij Ligji është SHTOJCA 1 - Lista e Komplekseve dhe Memorialëve, e cila mund të plotësohet me propozim nga Komunitet dhe Institucionet e Republikës së Kosovës, si vijon :

1. KK Suhareka:

- Memoriali i viktimave civile Suharekë
- Vendi i masakrës së familjes Berisha në qendër të Suharekës
- Varrezat e Dëshmorëve në Suharekë, Bllace, Grajqec, Papaz, Dardhishtë e Epërme dhe e Ulet, Budakovë, Muhlan, Reqan, Boksh, Vrani, Mushtisht, Maqitevë, Greikoc, Sopi, Dubravë, Shiroke leshan, Samadregjë, Studenqan, Reshtan, Peqan, Sllapuzhan, Gallushe e Peqanit, Nishor, Biraqe, Stravuinë, Luzhnicë, SuharekëBukogllave dhe Qafe te Duhlës.
- Varrezat e dëshmorëve dhe lapidari i UÇK-së Doberdolan.

2. KK Prizren:

- Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” Landovicë Prizren
- Memoriali i” Martirëve” Krushë e Vogël
- Varrezat dhe Lapidarët në Lez, Kushnin, Jeshkovë, Lubiqevë, Kabash, Piranë, Zojz , Hoçë e Qytetit, Vermicë,
- Memoriali i Martireve në Korishë.

3. KK Obiliq:

- Memoriali i martirëve të lirisë – Obiliq
- Busti i komandantit të UÇK-së “ Adem Jashari” – Obiliq
- Shtatoja e atdhetarit Aziz Zhilivoda, dhe Busti i dëshmorit Fahri Fazliu – Obiliq
- Monumenti – Obelisku i dëshmorit Ferid Currit – Mazgit i Ulët
- Monumenti i martirëve të UÇK-së – Hade
- Lapidari i lirisë – Hamidi
- Varrezat e dëshmoreve të UÇK-se – Sibovc
- Monumenti i luftës së UÇK-së Shipitullë

4. Hani i Elezit:

- Kompleksi i varrezave të dëshmorëve të UÇK-së në Puset e Nikës – Hani i Elezit
- Pllaka përkujtimore në Domjak, masakrës së vitit 1912 nga kriminelin Gjeneral Jankovic.
- Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së Feriz Guri – komandant Shpata dhe Xhevdet Guri
- Pllaka përkujtimore e Ilaz Thaqit dhe Gazetarit Anglez- Karem Lewton në Krivenik

5. KK Viti:

- Memoriali “Mehdi Korrani” Pozharan
- Bustet e ” Njazi Azemi dhe Bafti Hagjiu” në viti
- Memoriali “Gursel e Bajram Sylejmani” - në fshatin Sadovinë
- Memoriali “Dëshmorët e Smirës” dhe Gjylekarit

- Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së Viti
- Memoriali i masakrës së vitit 1912
- Lapidari i veprimtarit dhe luftëtarit të shquar Hysen Tërpeza – Tërpezë
- Lapidari i Karem Lewton Gazetar Anglez në Viti

6. KK Skenderaj:

- Kompleksi Memorial “ Adem Jashari “ Prekaz
- Qendra Memoriale Dëshmorët e UÇK-së Marinë
- Memoriali i” Masakra e Likoshanit , Likoshan - Qirez
- Memoriali i Masakres së Izbicës- Izbicë
- Memoriali Dëshmorëve dhe Martirëve në Rezallë
- Memoriali Tahir Meha ne Prekaz
- Kompleksi memorial ne Likoc, ku gjendet Shtabi dhe Ambullanca UÇK-së dhe varrezat e Dëshmorëve te UÇK-së
- Varrezat e dëshmorëve te UÇK-së Palac
- Edhe Shumë varreza te dëshmorëve te UÇK-së nëpër fshatrat e komunës së Skenderajt.

7. KK Dragash:

- Qendra Përkujtimore e Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në qytetin e Dragashit
- Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së ne fshatin Buqe
- Varreza e Dëshmorëve të rënë në betejë në vitin 1912 në fshatin Brodosanë

8. KK Kamenicë:

- Memoriali i varrezave të dëshmorëve te UÇK-së Kamenicë
- Qendra memoriale e shtabit te UÇK-së, “Brigada 172” në Hogosht – Bujnoc
- Varri i dëshmorit të tri luftimeve (Kosove, Preshevë –Medvegjë - Bujanoc, Maqedoni) Rrahim Beqiri - Kopernicë .
- Memoriali i veprimtarit te Shquar Kombetar Metush Krasniqi – Dajkoc
- Memoriali i Dëshmorit të Kombit “Kadri Zeka” Poliçkë
- Sheshi Memorial i LNDSh- ne Topanicë dhe Shipashnicë të Epërme
- Memoriali “Shtëpia Muze e Isa Kastrati: Hogosht

9. KK Rahovec:

- Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” Xërxë
- Varrezat e Dëshmorëve të Rahovecit
- Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve në Pastaselë, Celinë,
- Varrezat e Dëshmorëve në fshatin Dejnë, ratkoc, Gradishë, Fortesë, Nagavc, Opterushë, Brestovc
- Memoriali i” Martirëve” Krushë e Madhe
- Memoriali Hoçë e Vogël

10. KK Lypjan:

- Kompleksi Memorial i Zonës së Veçantë “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë” – Malet e Berishës.
- Memoriali i martireve ne Sllovi, Ribare i Vogel, Hallaq i Vogël, Dobrajë e Madhe,
- Qendra Memoriale e Monumentale e Rambujes në Shalë (Sadllar)
- Varrezat e martirve Vershec-Blinajë.
- Memoriali i Dëshmorëve te kombit grackë e Vogël, memoriali,
- Memoriali i masakrës ne Lypjan, Masakra e Bujanit
- Memoriali i Dëshmorëve te Krojmiri

11. KK Podujevë:

- Kompleksi “Kulla e Zahir Pajazitit” Orllan

- Kompleksi i varrezave te Dëshmorëve Penuhë
- Obelisku “ Afrim Zhitia” Llugë
- Varrezat e Martirve Dyç,
- Sheshi Qëndresa dhe monumenti Xhemajl Mustafa - Gllamnik,
- Varrezat e Dëshmorëve dhe pllaka përkujtimore – Tabet e Llapashticës

12. KK Pejë:

- Shtëpia Shtabit të UÇK-së Kuqishtë – Rugovë
- Varrezat e dëshmorëve Jablanicë e Ulët
- Memoriali Masakra e martireve Çyshk
- Memoriali Masakra e martireve Lybeniq

13. KK Ferizaj:

- Varrezat e dëshmorëve Ferizaj
- Memoriali “Epopeja e Jezercit” Jezerc
- Varrezat e dëshmoreve të UÇK-së Pleshinë,
- Varrezat e dëshmoreve të UÇK-së Greme

14. KK Shtime:

- Memoriali “Masakra e Raçakut” Raçak
- Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së – Shtime
- Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së – Mollopolc

15. KK Junik:

- Sheshi dhe Përmendorja e heroit Edmond Hoxha – Qendër të Junik

16. KK Novobërdë: - nuk ka komplekse, memoriale dhe varreza te dëshmorëve

17. KK Drenas:

- Memoriali “Masakra e Likoshanit” Likoshan
- Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së ne Gllanasellë, Komoran, Vasilevë, Gradicë, Shtrubullova, Krajkovë, Domanek, Baicë, Abri, Terdevc, Terstenik, Shtuticë, Verbovc, Negrovc, Llapushnik.
- Memoriali maskra e Abrisë - familjes Delijaj, Poklek te Vjetër
- Varrezat e martireve ne Qikatovë të Vjeter, Qikatovë të Re, Gllobarë, Llapushnik,

18. KK Prishtinë:

- Memoriali Ibrahim Rugova dhe varrezat e dëshmorëve të UÇK-së Prishtinë
- Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së, Mramor, Marec,
- Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së dhe martirëve në Makoc

19. KK Vushtrri:

- Memoriali i Dëshmorëve te UÇK-se Vushtrri
- Memoriali i dëshmorëve te UÇK-së Bletajë
- Memoriali Martirët e Lirisë në Vushtrri,
- Varrezat e Martirëve Vushtrri, Studime,
- Shtatorja e “Adem Jasharit, Azem Bejtes, Vushtrri
- Përmendorja e Dëshmorëve Zahir Pajazitit-Edmond Hoxha-Hakif Zejnullahu Pestovë

20. KK Klinë

- Memoriali i varrezave te Dëshmorëve te UÇK-së Grabanicë
- Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së dhe Mujë Krasniqit Klinë
- Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së dhe martirve në Drenoc, Rigjevë, Zaberrgjë, Qabiq,

- Memoriali Marie Shllaku dhe Imer Berisha - Doberdol
- Memoriali i Azem Bejtes pran Magjistrales Prishtinë - Pejë

21. KK Deçan:

- Kompleksi Memorial Shtabi i UÇK-së dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së” Gllogjan Deçan
- Memoriali i Dëshmorëve – Strellc i Eperm, Lebushë, Isniq, Ratishë e Ulët, Gramaqel, Baballoq, Prejlep, Beleg, Carabreg i Eperm, Carrabreg i Ulët, Pobergj, Irzniq, Sllup,
- Lapidari i Dëshmorëve të kombit në Deçan, Luan Haradinaj, Salih Çeku, Mentor Tolaj
- Memoriali i Heronjve të kombit- Vëllezërit Gërvalla – Dubovik
- Kompleksi memorial – Pajtimi i gjaqeve dhe varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Lumbardh.

22. KK Gjilan:

- Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së në Gjilan
- Sheshi dhe Busti Idriz Seferi - fshati Zhegër
- Varrezat e viktimave civile – Lladovë dhe Llashticë
- Memoriali i te gjithë Dëshmorëve të UÇK-së Zhegovc
- Sheshi dhe Lapidari i Lirisë për të rënë nga 1912 deri 1999 në Bresalc

23. KK Malishevë:

- Kompleksi Z.V. “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë” – Malet e Berishës
- Varrezat e Dëshmorëve ne Malisheve
- Varrezat e martireve ne Malishevë
- Varrezat e dëshmorëve të periudhave të ndryshme të historisë sonë
- Varrezat e masakrës së Burimit – Dragobil
- Zona e funksionimit te spitalit ushtarak të UÇK – së Gajrak dhe Kravasari
- Shtabi i UÇK-së 1998-1999, Brigada 122 Dragobil

24. KK Gjakovë:

- Kompleksi Z.V. “Beteja e Koshares” Koshare
- Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” Jabllanicë
- Varrezat e “Martirëve” Çabrat
- Memoriali i” Martirëve” Meje

25. KK Mitrovica:

- Memoriali i varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së” Shipol
- Sheshi memorial i Jasharajve dhe sheshi Fehmi e Xhevë Lladrovci
- Shtëpia Memoriale Ne Mazhiq
- Shtëpia përkujtimore lagja e Boshnjakeve
- Varrezat e martireve Mazhiq
- Permendoret Memoriale te heronjve Mitrovicë
- Shtëpia Memoriale e Isë Boletinit - Boletin

26. KK Istog:

- Memoriali i Dëshmorëve në Vrellë
- Memoriali i Dëshmorëve në Istog
- Varrezat e Dëshmorëve në Trubohoc
- Varrezat e Dëshmorëve në Shushicë

27. KK Fushë Kosovë:

- Varrezat e Dëshmorëve dhe martirëve në F. Kosovë

28. KK Kaçanik:

- Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së Kaçanik
- Varrezat e Martirëve Kaçanik
- Memoriali “Fshati Muze Struzhë” i djegur dhe shkatërruar tri herë, në dy luftërat botërore dhe për të tretën herë në Luftën e fundit me 1999.

Komisioni në fund nxori :

P Ë R F U N D I M

Pas rishikimit të Amendamenteve nga Departamenti Ligjor i Kuvendit, të procedohet Projektligji tek Komisionet e Përhershme të Kuvendit dhe për leximin e dytë.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit rikujtoi anëtarët e komisionit që dje në tryezën e punës të mbajtur nga Komisioni, më 10 dhjetor 2012 është proceduar Projektligji për Pyje (me votim **4 për** dhe **një kundër**) në leximin e parë, me rekomandimin për mos miratim, për shkak të konfliktit të kompetencave në mes dy ministrive (MMPH dhe MBPZHR) rreth menaxhimit.

Kryetari i Komisionit parashtroi iniciativën rreth propozimit të ZRRUK me të cilën kërkohet nga ky Komision autorësia për hartimin e Ligjit Nr. 03/L-086 përkatësisht zëvendësimin me një Ligj tjetër. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET nisma për hartimin e Projektligjit për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit , ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë sipas Nenit 53 dhe 54 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani